

Kodi i etikës

SHRUKV sh.a është një shoqëri tregtare e cila ka për objekt furnizimin me ujë të popullatës dhe subjekteve në të gjithë zonën e shërbimit për të cilën shoqëria është e licensuar, sipas kuadrit ligjor në fuqi. Aktiviteti i Shoqërisë është një shërbim publik. Përveç faktit që furnizimi me ujë është shërbim publik Shoqëria ka për qëllim krijimin e te ardhurave dhe realizimin e fitimeve.

Duke patur parasysh qëllimet e funksionimit të shoqërisë punonjësit e SHRUKV sh.a duhet të kenë parasysh që Klienti është prioriteti i Shoqërisë dhe që çdo veprim dhe aktivitet i punonjësit të shoqërisë matet në raport me aftësinë për të kënaqur dhe plotësuar kërkesat e klientit. Nisur nga sa më sipër punonjësi është i detyruar të :

Tregojë mirësjellje dhe aftësi për të dëgjuar kërkesat dhe problemet e klientit;

Gjejë ose drejtojë klientin drejt një zgjidhje për kërkesën e tij, duke respektuar legjislacionin në fuqi në fushën e aktivitetit të Shoqërisë;

Krijojë një raport besimi me klientin. Shërbimi i mirë është i detyrueshëm dhe nuk përbën lajm. Mbajë të rregullt ambientin e punës duke mbrojtur imazhin e Shoqërisë.

Ketë një sjellje të rregullt me kolegët në prani të klientit.

Të procedojë në kohën më të shkurtër administrative të gjitha kërkesat e klientit.

Në kryerjen e funksioneve e detyrave të përcaktuara në këtë rregullore, punonjësit e SHRUKV sh.a. duhet të respektojnë parimet si më poshtë:

të kryejë detyrat, në përputhje me legjislacionin në fuqi;

të veprojë në mënyrë të pavarur nga pikëpamja politike e të mos pengojë zbatimin e politikave, të vendimeve ose veprimeve ligjore të eprorëve;

në kryerjen e detyrave duhet të jetë i ndershëm, i paanshëm, efikas, duke pasur parasysh vetëm interesin publik;

të eliminojë, mungesën e respektit ndaj të tjerëve, padrejtësitë dhe pandershmëritë;

të përkrahë, si formalisht, ashtu edhe shpirtërisht, frymën që përçojnë parimet, ligjet, aktet nënligjore, rregullat dhe udhëzimet që zbatohen në Institucion

të mos jetë indiferent kur duhet të përballlet me probleme etike;

Inkurajojë dialogun, diskutimet e hapura dhe pa paragjykim;

të respektojë standardet bazë të sjelljes si brenda, ashtu dhe jashtë mjedisit të Institucionit; të jetë modest lidhur me atë që mund të përmirësohet dhe mënyrën se si mund të bëhet ajo.

nuk duhet të veprojë arbitrarisht në dëm të një personi ose organizate dhe duhet të tregojë respektin e duhur, për të drejtat dhe interesat personale të të tretëve;

të mos lejojë që interesat e tij private të bien ndesh me punën që kryen në SHRUKV sh.a., të shmangë konfliktet e interesave dhe të mos shfrytëzojë asnjëherë pozitën për interesin e tij privat;

të sillet gjithnjë në mënyrë të tillë, që besimi i publikut në ndershmërinë, paanshmërinë dhe efektivitetin e shërbimit publik të ruhet e të rritet;

të ruajë konfidencialitetin e informacionit, që ka në zotërim, por pa cënuar zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga ligji nr.119/2014, "Për të drejtën e informimit".

Të zbatojë dispozitat e ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale.